



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SARANDË**  
**KESHILLI**

**V E N D I M**

**Nr.45 dat 05/ 12 /2017**

**PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE TË VITIT 2018**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 05/12/ 2017 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore “**Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2018**”, në zbatim të Ligjit nr **139/2015** “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni **54** pika **f** ,Ligjit Nr.**9632** datë **30.10.2006** “Per sistemin e taksave vendore” i ndryshuar ,Ligjit nr **9920** datë **19.05.2008** “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetqeverisjes Vendore”.

**V E N D O S I :**

- l. Të miratohet Paketa fiskale e vitit 2018 sipas materialit bashkangjitur:

**KRYETARI**

**TATJANA ALIKAJ**

## **A.TAKSAT VENDORE**

### **A.1.TATIM I THJESHTRUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL**

Shkalla tatimore do të jetë:

- Për subjektet me xhiro deri 5 milionë lekë, 0 lekë/vit.
- Për subjektet me xhiro 5 deri 8 milionë lekë, 5 % mbi fitimin.
- Për subjektet me xhiro 5-8 milionë lekë, pagesa do të kryhet në katër këste, brenda datave: 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor, të çdo viti.
- Për administrimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për biznesin e vogël, është ngarkuar Drejtoria Rajonale Tatimore. Të ardhurat e realizuara prej tij do të derdhen për llogari të Bashkisë çdo datë 10. Shpërblimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore do të jetë 1% e shumës së derdhur për llogari të Bashkisë.

### **A.2.TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME**

Taksës mbi pasuritë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme në territorin e Bashkisë Sarandë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

Taksa mbi pasuritë e paluajtshme përbëhet nga:

- ❖ Taksa mbi ndërtesat
- ❖ Taksa mbi tokën bujqësore
- ❖ Taksa mbi truallin

#### **A.2.1.TAKSA MBI NDËRTESTAT**

<b>Kategoritë e ndërtesave</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>2018</b>
2.1. Ndërtesa banimi (familjare)		
a) Bashkia Sarandë (Njësia administrative Sarandë)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	10
b) Njësia administrative Ksamil	lekë/m <sup>2</sup> /vit	6
2.2. Ndërtesa të tjera për tregëti dhe shërbime		
a.)Bashkia Sarandë (Njësia administrative Sarandë)		
- zona A	lekë/m <sup>2</sup> /vit	300
- zona B	lekë/m <sup>2</sup> /vit	210
b)Njësia administrative Ksamil		
- zona A	lekë/m <sup>2</sup> /vit	210
- zona B	lekë/m <sup>2</sup> /vit	180
2.3Ndërtesa në pronësi apo në përdorim në teritore të Miratuara si fshatra turistike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	400
2.4 Të tjera		
a.)Bashkia Sarandë (Njësia administrative Sarandë)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	60
b.)Njësia administrative Ksamil	lekë/m <sup>2</sup> /vit	40
2.5 Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese		
a.)Bashkia Sarandë (Njësia administrative Sarandë)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	150
b.)Njësia administrative Ksamil	lekë/m <sup>2</sup> /vit	100

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit (në metër katror), e ndërtesës ose e pjesës

së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqia në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi dhe në rastin e mungesës së dokumentacionit, sipërfaqet verifikohen nga komisioni i ngritur me vendim të Këshillit të Bashkisë.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore njeh si dokumentacion një nga dokumentat e mëposhtme:

- Vërtetimin e pronësisë
- Vendimet e komisionit të kthimit të pronave
- Vendimet e privatizimit
- Vetëdeklarimin
- Vendimet e komisionit të verifikimit të pasurive të paluajtshme

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Afati i pagesës së saj do të jetë:

- Për subjektet që kanë në pronësi ose administrim ndërtesa me sipërfaqe nën 500 m<sup>2</sup>, afati maksimal do të jetë data 31 maj.
- Për subjektet që kanë në pronësi ose administrim ndërtesa me sipërfaqe mbi 500 m<sup>2</sup> afati maksimal i pagesës do të jetë data 31 gusht.

Taksa e ndërtesës për familjet që nuk kanë dokument ligjor, aplikohet me një vlerë fikse prej 960 lekësh. Taksapaguesit familjarë që kanë në pronësi më shumë se një banesë, për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës sipas pikës 2.1, ndërsa për gjithë shtëpitë e tjera, taksa e ndërtesës do të jetë sa dyfishi i saj. Kjo taksë mund të vilet edhe nëpërmjet një Agjenti Tatimor, të përzgjedhur prej Kryetarit të Bashkisë.

Marrëdhëniet me Agjentin Tatimor rregullohen nëpërmjet kontratës së posaçme.

Agjenti Tatimor shpërblehet në masën **5 %** të shumës së arkëtuar.

Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pashitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës.

Ambientet e hipotekuara si:

- ❖ apartamente banimi do t'i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategoritë “ndërtesa banimi”
- ❖ ndërtesat e biznesit do t'i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat, në kategoritë “ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime”.

Përfshihen nga taksa mbi ndërtesën e banimit, personat që u lind detyrimi për këtë taksë kur janë invalidë, veteran të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidë të punës, të verbërit, invalidë paraplegjikë tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për Statusin e Veteranit të Luftës kundër pushtuesit nazifashistë të popullit shqiptar”, ligjit nr. 8098 datë 08.03.1996 “Për statusin e të verbërit dhe ligjit nr 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Taksës mbi ndërtesat për subjektet, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Sarandë.

**Ndarja në zona A dhe B, do të jetë sipas hartës bashkëlidhur për qytetin e Sarandës dhe Njësinë Administrative Ksamil.**

Vijat kufizuese të zonës “A”, të cilat janë akse rrugësh kryesore, do të konsiderohen zona “A” në të dy krahët e saj.

### A.2.2.TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

	<b>KATEGORIA E TOKËS</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>2018</b>
1	Kategoria I	Lekë/ha/vit	5600
2	Kategoria II	Lekë/ha/vit	4900
3	Kategoria III	Lekë/ha/vit	4200
4	Kategoria IV	Lekë/ha/vit	3600
5	Kategoria V	Lekë/ha/vit	3000
6	Kategoria VI	Lekë/ha/vit	2400
7	Kategoria VII - X	Lekë/ha/vit	1800

Përfshihen nga taksa mbi tokën bujqësore sipërfaqet që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari, për pesë vjetët e para nga çasti i mbjelljes.

Taksa e tokës bujqësore mbledhet me agjent tatimor ose direkt nga strukturat tatimore të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Agjenti tatimor shpërblehet në masën 5 % të shumës së mbledhur dhe arkëtuar për llogari të Bashkisë.

Agjenti tatimor përzgjidhet nga Kryetari i Bashkisë dhe marrëdhëniet me të rregullohen nëpërmjet kontratës së posaçme.

### A.2.3.TAKSA MBI TRUALLIN

Me “truall”, nënkuptojmë një sipërfaqe toke, jo bujqësore që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në meter katrorë, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim pranë Bashkisë ku ndodhet trualli.

	<b>Taksë trualli</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>2018</b>
1	Truall për qëllime banimi nga individët	Lekë/m <sup>2</sup> /vit	0.56
2	Truall për qëllime biznesi	Lekë/m <sup>2</sup> /vit	20

### A.3.TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndrimit në hotel, për person.

Janë subjekt i taksës të gjitha veprimtaritë që japin strehim kundrejt pagesës, si: hotelet, motelet, stabilimentet turistike, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizmi familjar dhe çdo objekt tjetër, që përdoret për këtë qëllim.

	Taksa e fjetjes në hotel	Njësia e matjes	2018
1.	Për hotelet me 4 -5 yje		
a	Bashkia Sarandë (njësia Sarandë)	Lekë/natë/qëndrimi	175
b	Njësia administrative Ksamil	Lekë/natë/qëndrimi	105
2	Hotelet me 3 dhe nën 3 yje – bujtinë,fjetinë,motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin.		
a	Bashkia Sarandë (njësia Sarandë)	Lekë/natë/qëndrimi	70
b	Njësia administrative Ksamil	Lekë/natë/qëndrimi	35

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Sarandë.

**Afati i pagesës do të jetë data 5 e muajit pasardhës për subjektet që deklarojnë dhe data 5 Shtator për subjektet e tjera që u maturohet detyrimi gjatë sezonit veror dhe që nuk kanë deklaruar.**

### A.4.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri, që kërkohet të kryhet, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për m<sup>2</sup> të investimit të ri.

Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse, përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	Njësia e matjes	2018
	Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi ose njësi shërbimi të ndryshme..		
	a) Zona A	Vlerë investimi	3 %
	b)Zona B	Vlerë investimi	2 %
	Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi ose njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.		
	a)Zona A	Çmimi/shitjes/m <sup>2</sup>	6%

	b)Zona B	Çmimi/shitjes/m <sup>2</sup>	4%
	c)Ndërtesa ne proces legalizimi	Vlerë investimi	0.5%
	d)Projekte të infrastrukturës	Vlere investimi	0.1%

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja, është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Struktura e ngarkuar për administrimin e saj është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimi të Territorit.

#### **A.5.TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË**

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme, në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë.

	<b>Kategoria</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>2018</b>
1	Ndërtesa banimi	lekë/m <sup>2</sup>	300
2	Ndërtesa për tregti dhe shërbime	lekë/m <sup>2</sup>	700
3	Ndërtesa të tjera	lekë/m <sup>2</sup>	500
4	Për truall e tokë bujqësore	Vlerë shitje	2%

Vjelja e kësaj takse bëhet nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila, në rolin e agentit të taksave, përfiton **3%** të shumës së arkëtuar.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës për zënien e hapësirës publike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

#### **A.6.TAKSA E TABELËS**

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet taksapaguese.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve, shërbimit të transportit të mallrave ose subjekte të tjera të shërbimit, të cilat nuk kanë mundësi praktike për vendosjen e saj.

Kategoritë dhe niveli i taksës jepen si në tabelën e mëposhtme:

<b>Taksë table</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>2018</b>
Tabelë për qëllime identifikimi të trupëzuara në ndërtesë ose brenda teritorit ku zhvillohet aktiviteti, me sipërfaqe deri në 2 m <sup>2</sup>	Lekë/m <sup>2</sup> /vit	0
Tabelë për qëllime identifikimi të trupëzuara në ndërtesë ose brenda teritorit ku zhvillohet aktiviteti, me sipërfaqe mbi 2 m <sup>2</sup> .	Lekë/m <sup>2</sup> /vit	31500
Tabelë për qëllime identifikimi jashtë teritorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	Lekë/m <sup>2</sup> /vit	120
Tabelë e thjeshtë për qëllime reklamimi	Lekë/m <sup>2</sup> /vit	13500
Tabelë elektronike për qëllime reklamimi	Lekë/m <sup>2</sup> /vit	27000
Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.	Lekë/m <sup>2</sup> /ditë	1000

Me tabelë për qëllime identifikimi kuptojmë:

- a) të gjitha tabelat, pavarësisht nga sipërfaqja, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda teritorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve.

Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.

- b) Me tabelë për qëllime reklamimi, kuptojmë të gjitha tabelat e vendosura në taraca llozhe, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj. larg vendndodhjes së biznesit, që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi, për vete ose të tretë. Sipërfaqe e përgjithshme e tyre konsiderohet pjesa që vendoset reklama dhe llogaritet gjatësi x gjërësi.

Leja për vendosjen e tabelave reklamuese jepet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Teritorit mbi bazën e së cilës lidhet kontratë nga Drejtoria Juridike dhe nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

**Detyrimi për taksën e tabelës është vjetor. Afati i pagesës është deri më 31 maj.**

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

## **B.TARIFAT**

### **B.1.1 TARIFA E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTET E BIZNESIT TË VOGËL**

	<b>Kategoria</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>2018</b>
1	Subjekte të tregtisë me pakicë me sipërfaqe deri 30 m <sup>2</sup> .	Lekë/vit	6000
2	Subjekte të tregëtisë me pakicë me sipërfaqe 31-50 m <sup>2</sup> .	Lekë/vit	7500
3	Subjekte të tregëtisë me pakicë me sipërfaqe 51-100 m <sup>2</sup> .	Lekë/vit	12000
4	Subjekte të tregëtisë me pakicë me sipërfaqe mbi 100 m <sup>2</sup>	Lekë/vit	25000
5	Subjekte të ndryshme shërbimi	Lekë/vit	8000

6	Subjekte prodhimi të ndryshme	Lekë/vit	15000
7	Subjekte të ndryshme transporti	Lekë/vit	6500
8	Subjekte të profesionit të lirë	Lekë/vit	15000
9	Subjekte ambulante (te tregjet)	Lekë/vit	4000
10	Kioska të ndryshme	Lekë/vit	4000
11	Stacione Plazhi për Siperfaqe të taksushme	Lekë/ m <sup>2</sup> /sezon	50
12	Subjekte në bulevardin Jonianët gjatë sezonit veror	Lekë/ m <sup>2</sup> /sezon	1500
13	Subjekte sezonale në teritorin tjetër të Bashkisë	Lekë/ m <sup>2</sup> sezon	1000
14	Për subjektet hoteljere (hotel, motel, turizëm familjar) të zones A Sarandë. Dhe Njësia Administrative Ksamil	Lekë/dhomë/vit	1500
15	Për subjektet hoteljere (hotel, motel, turizëm familjar) të zones B Sarandë dhe Nj.A. Ksamil	Lekë/dhomë/vit	1000

**Tarifa e shërbimeve publike është vjetore dhe do të llogaritet për çdo muaj të punuar.** Përfshihen nga ky rregull subjektet hoteljere. Detyrimi i tyre do të jetë sipas vlerës në tabelën e mësipërme.

Në rastet kur subjekti hotelier ka edhe bar apo restorant, detyrimi për to do të llogaritet në varësi të sipërfaqes, me nivelin e subjekteve të tregëtisë me pakicë.

**Afati i pagesës do të jetë jo më vonë se data 31 gusht.**

#### **B.1.2.TARIFA E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTE TË BIZNESIT TË MADH**

	<b>Kategoria</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>2018</b>
1	Shoqëritë e ndërtimit	Lekë/vit	95.000
2	Shoqëritë tregëtare,prodhuese,shërbimi	Lekë/vit	80.000
3	Shoqëritë anonime dhe filiale të kasinove	Lekë/vit	250.000
4	Filiale të tjera të SH.A. - ve	Lekë/vit	130.000
5	Institucionet Shtetërore	Lekë/vit	10.000
6	Subjekte që kryejnë shërbime për të tretë për rimbushje karta elektronike të telefonisë Digitalb etj.	Lekë/vit	40.000

Subjektet me status “Biznes i Madh”, me veprimtari ekonomike: tregëti, prodhim dhe shërbime, që operojnë në teritorin në juridiksion të Bashkisë Sarandë, por që selinë e tyre dhe veprimtarinë kryesore e kanë jashtë këtij territori, trajtohen me 50% të nivelit të tarifave për shërbimet publike që trajtohen subjektet respektive.Në pikën 6 përfshihen subjektet që statusin si biznes i madh e kanë përfutuar kryesisht nga shërbimet që kryejnë për të tretë për rimbushje elektronike në marëveshje me kompanitë e telefonisë celulare Digitalb etj.



Ndërsa shoqëritë e ndërtimit, edhe kur nuk e kanë selinë në territorin e Bashkisë, paguajnë të njëjtin nivel tarifash.

Detyrimi për tarifën do të llogaritet për kohën e kryerjes së aktivitetit.

**Afati i pagesës do të jetë data 31 gusht.**

### **B.1.3.TARIFA PËR SHËRBIME TË TJERA**

	<b>Kategoria</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>2018</b>
1	Për familjarët	lekë/vit	3600
2	Për lëshim vërtetim nga arkivi	lekë/rast	500
3	Informacion për zyra avokatie	lekë/rast	3500
4	Informacion tekniko-ligjor për publikun	lekë/rast	1000
5	Tarifë për okupim sallë kinoteatër	lekë/rast	10000
6	Tarifë për okupim të stadiumit të futbollit	lekë/rast	30000
7	Tarifë për lojë në fusha të minifutbollit	lekë/lojtar	200
8	Tarifë për lojë në fusha të basketbollit	lekë/lojtar	50
9	Tarifë për biletë hyrje në kinoteater	lekë	200
10	Tarifë për biletë hyrje në muze dhe galerinë e arteve	lekë	100
11	Tarifë për biletë hyrje në stadiumin e futbollit	lekë	100
12	Për vërtetime të lëshuara nga Zyra e Gjëndjes Civile (vërtetim banimi, ndryshim emri / mbiemri, bashkëjetese etj.)	lekë/rast	100

<b>Tarifa e shërbimit për familjarët për shërbimet që ofron Bashkia ndahet:</b>	<b>2018</b>
-Tarifë pastrimi	<b>2000</b>
-Tarifë ndriçimi	<b>1200</b>
-Tarife gjelbërimi	<b>400</b>

Tarifa e Shërbimit për familjarët do të mblidhet nga Agjenti Tatimor, përkundrejt shpërblimit 5 % të shumës së arkëtuar.

Agjenti zgjidhet nga Kryetari i Bashkisë. Marëdhënia me të rregullohet me kontratë të posaçme.

Përfshihen nga tarifa e shërbimit personat që u lind detyrimi për tarifën kur janë individë, veteran të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidë të punës, të verbërit, invalidë paraplegjike, që e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr.7874, date 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesit nazifashistë të popullit shqiptar” i ndryshuar, ligjit nr.8098 datë

28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” dhe ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”.  
Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimit ,për subjektet është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Sarandë.

## **B.2. TARIFA QË DO TË APLIKOHEN NGA THERTORJA E ADMINISTRUAR NGA BASHKIA**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi i bagëtive</b>	<b>Njësia e matje</b>	<b>2018</b>
1	Viça deri 150 kg (peshë e gjallë)	Lekë/kokë	1000
2	Mëshqera, mëzetër, 151-300 kg	Lekë/kokë	1500
3	Lopë, dema, mbi 300 kg	Lekë/kokë	2000
4	Gica deri ne 50 kg	Lekë/kokë	400
5	Dosa. Derra, mbi 50 kg	Lekë/kokë	600
6	Qëngja (1 Dhjetor- 28 Shkurt),12-17 kg	Lekë/kokë	100
7	Qëngja, keca (1 Mars-30 Nëntor) 18-28 kg	Lekë/kokë	150
8	Dele, dhi,	Lekë/kokë	200
9	Tarifë lëshimi çertifikat veterinare në thertore	Lekë/raste	200

## **B.3 TARIFA QË DO TË APLIKOHEN NGA KONVIKTI I SHKOLLËS SË MESME**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi i tarifës</b>	<b>Njësia matjes</b>	<b>2018</b>
1	Tarifë për fjetje në konvikt nxënës e studentë	Lekë/vit/shkollo	30000
2	Tarifë fjetje për individë		
-	Për dhomat teke	Lekë/natë	800
-	Për dhomat dyshe	Lekë/natë	1400
-	Për dhomat treshe	Lekë/natë	1800

## **B.4 TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE**

	<b>Tarifë shërbimi për parkimin e automjeteve</b>	<b>Njësia matjes</b>	<b>2018</b>
1	Autovetura Taksi	Lekë/vit	3000
2	Furgonë dhe mikrobuzë për transport pasagjerësh	Lekë/vit	3000
3	Autobuz	Lekë/vit	5000
4	Autobuz vend parkim i miratuar	Lekë/orë	50
5	Automjet transport malli deri 3.5 ton	Lekë/vit	3000

6	Automjet transport malli mbi 3.5 ton-8 ton	Lekë/vit	5000
7	Automjet transport malli mbi 8 ton-14 ton	Lekë/vit	6000
8	Automjet transport malli mbi 14 ton	Lekë/vit	8000
9	Për parkim të rezervuar vjetor vlefshmëri 365 ditë	Lekë/vit	35000
10	Për parkim të rezervuar 6-mujor	Lekë/6-mujor	22000
11	Tarifë parkimi(parkim me pagesë)(1 prill-30 shtator)	Lekë/orë	100
12	Tarifë parkimi(parkim me pagesë)(1 tetor-31 mars)	Lekë/orë	50

Përjashtohen nga tarifa e parkimit të automjeteve mjetet e transportit pronë e subjekteve të prodhimit bujqësor brenda Bashkisë Sarandë kur këtë e vërtetojnë me paraqitjen e NIPT-it të Fermerit.

Struktura e ngarkuar për administrimin e tarifës së parkimit të automjeteve është Drejtoria e Shërbimeve.

## **B.5.TARIFA PËR ZËNIEN E HAPËSIRËS PUBLIKE**

Baza e tarifës për zëniet e hapësirave publike është sipërfaqja në m<sup>2</sup>, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

<b>1.Zënie e hapësirës publike</b>	<b>Njesia matjes</b>	<b>2018</b>
<b>A.Hapësirë publike në “Bulevardin Jonianët”</b>		
- Përdorim vjetor	Lekë/ m2/muaj	220
- Përdorim sezonal	Lekë/ m2/ditë	50
<b>B. Hapësirë publike nëpërdorim vjetor</b>		
- Zona A (Sarandë dhe Ksamil)	Lekë/ m2/muaj	200
- Zona B (Sarandë dhe Ksamil)	Lekë/ m2/muaj	100
<b>C. Hapësirë publike gjatë sezonin turistik (sezonale)</b>		
- Sarandë dhe Ksamil	Lekë/ m2/ditë	40
<b>D. Hapësirë në tregjet publike administruar nga Bashkia</b>	Lekë/ m2/muaj	120

Sipërfaqja që do të përdoret dhe koha e përdorimit të saj do të përcaktohet me autorizim nga Drejtoria e Shërbimeve.

Detyrimi për tarifën përlllogarit si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelin tregues të saj.

Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk aplikohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës për zënien e hapësirës publike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

**B.6.TARIFAT QE APLIKOHEN NGA DREJTORIA E SHERBIMEVE****B.6.A. PËR LIÇENCA/ÇERTIFIKATA QË LËSHOHEN NË FUSHËN E TRANSPORTIT RRUGOR**

Nr.	EMËRTIMI	Njësia e matjes	Tarifa në lekë 2018	
			Afati 10 vjet	Afati 5 vjet
I	<b>TRANSPORT UDHËTARËSH</b>			
	Brënda vendit			
1	Liçencë për kryerjen e shërbimeve në linjë të rregullt qytetëse të udhëtarëve.	Për linjë	80 000	=
	- Çertifikat për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.	Për mjet	=	5000
2	Liçencë për kryerjen e shërbimeve në linjë të rregullt rrethqytetëse të udhëtarëve .	Për linjë	40 000	=
	-Çertifikat për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse.	Për mjet	=	7 500
			Afati 5 vjet	
3	Liçencë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të udhëtarëve	Për linjë	20 000	
	- Çertifikat për kryerjen e shërbimeve të rregullta specializuara të udhëtarëve	Për mjet	7 500	
4	Liçencë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerë të udhëtarëve	Për linjë	20 000	
	Çertifikat për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje(lavjerrë të udhëtarëve	Për mjet	7 500	
5	-Çertifikat për transportin e udhëtarëve për llogari të v brënda vendit.	Për mjet	7 500	
6	Liçencë për transport udhëtarësh me taksi.	Për mjet	20 000	
II	<b>TRANSPORT MALLRASH</b>			
	Brënda vëndit			
1	Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brënda vendit.	Për liçencë	40 000	
	-Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brënda vendit.	Ton /kapac	100*	
2	-Çertifikat për transport mallrash brënda vendit për llogari të vet .	Ton / kapac	100*	
3	-Çertifikat për tërheqës.	Për tërheqës	7 500	
III	<b>SHËRBIME TRANSPORTI</b>			
1	Liçencë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brënda vendit.	Për liçencë	15 000	
2	Liçencë për agjensi transporti ndërkomëtar udhëtarësh.	Për liçencë	40 000	
IV	<b>VEPRIMTARI TË TJERA</b>			
1	-Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet	Ton/kapac	100*	
2	-Çertifikatë për tërheqës	Për tërheqës	7 500	

<b>V</b>	<b>SHERBIME TRANSPORTI</b>		
1	Liçencë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi Brenda vendit	Për liçence	15 000
2	Liçence për agjensi transporti ndërkombëtar udhëtarësh	Për liçence	40 000
<b>VI</b>	<b>VEPRIMTARI TË TJERA</b>		
1	Autorizim i përkohshëm një mujor.	Për autorizim	2 000
2	Autorizime të ndryshme .	Për autorizim	300

**Shënim:**

- a) Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30% e vlerës së plotë.
- b) Për rastet e ndryshimeve në liçencë/çertifikatë që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj., paguhet 30 % e vlefshërisë së plotë.
- c) \* Vlera e çertifikatës për transport mallrash del nga shumëzimi i vlerës së dalë nga llogaritja e tonë/kapacitetit me tarifën dhe nr.viteve që do të lëshohet çertifikata.

Tarifat janë të miratuara nga Ministria e Financave me shkresën 13786/1 datë 27.1.2010 dhe shkresën nr.17905/1, datë 27.12.2016 .

**B.7.B. SHËRBIME TË TJERA**

Nr.	EMËRTIMI	Njësia matjes	2018
1	Për lëshim autorizime të ndryshme	Lekë/autorizim	500
2	Për ndërhyrje të autorizuar në rrugë e trotuare nga qytetar e subjekte të ndryshme për nevojat e tyre.	Lekë/m <sup>2</sup>	3615
3	Zënie e hapësirës publike për ngritje kantieri për objekt gjatë ndërtimit.	Lekë/m <sup>2</sup> /dite	50
4	Për përdorim të autorizuar të rrugës dhe pjesëve të saj si si dhe mjedise të tjera publike.	Lekë/orë pune	1000
5	Tarifë për shërbim varimi nga Njësia e Bashkisë brenda varezës publike të qytetit të Sarandës. -shërbim për varr të ri -shërbim në varr ekzistues	Lekë/rast Lekë/rast	23000 6000
6	Tarifë shërbimi varimi për shoqëritë e liçencuara	Lekë/rast	5000
7	Tarifë shërbimi për ndertim, rikonstruksion,veshje varesh për subjektet që kryejnë këtë shërbim.	Lekë/rast	2000
8	Tarifë për përdorim të shezlogeve në plazhet që administrohen nga Bashkia	Lekë/shez/dite	150
9	Tarifë për dhënie “Deklaratë pastërtie”	Lekë/rast	5000
10	Leje ushtrim aktiviteti “non stop” , 24 orë	Lekë/vit	20000
11	Autorizim për lëvizje në krah të kundërt të automjeteve të ndryshme	Lekë/rast	5000

12	Tarifë për uitje dhe kullim për sezon	Lekë/për dynim	300
13	Tarifë shërbimi për rjetin telef.TV Kabllor,internet a- në linjat ajrore b- në linjat nëntokësore	Lekë /km/vit Lekë/km/vit	2000 1500
14	Tarifë për përdorimin e platformave pluskuese në det Për organizimin e lojrave të ujit.	Lekë/m <sup>2</sup> /sezon	20
15	Tarifë shërbimi për punime elektrike në lartësi me automjet të Bashkisë për të tretë.	Lekë/orë	4000
16	Tarifë për çfytëzimin e koridoreve ujore	Lekë/sezon	
	-Xhetski	Lekë/sezon	10000
	-Motoskafë deri 25 c	Lekë/sezon	6000
	-Motoskafë mbi 25 c	Lekë/sezon	10000
	-Jahte	Lekë/sezon	20000
	-Velierë e mjete të tjera turistike	Lekë/sezon	30000

Baza e tarifës për linjat ajrore dhe nëntokësore është gjatësia lineare për kilometer të linjave ajrore dhe nëntokësore të cilat vihen në shfrytëzim nga subjektet për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare) me nivelin e saj.

Tarifa për çfrytëzimin e koridoreve ujore perdoret per mjetet qe kryejne aktivitet ne fushen e shërbimit turistik.Perjashtohen nga kjo tarife mjetet e peshkimit.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Drejtoria e Shërbimeve Publike.

## **B.8. TARIFAT PËR SHËRBIMET QË KRYEN DREJTORIA E PLANIFIKIMT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERITORIT**

<b>Nr</b>	<b>EMERTIMI I TARIFES</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>2018</b>
1	Kontrolli i fazave te punimeve të ndërtimit		
a	Piketimi i objektit: Objekte deri në tre kate	lekë	4000
	Objekte mbi tre kate	lekë	6000
b	Përfundimi i kuotës +0.00m të objektit		
	Objekte deri në tre kate	lekë	4000
	Objekte mbi tre kate	lekë	6000
c	Përfundimi i karabinase së objektit		
	Për çdo kat	lekë	3500
d	Përfundimi i sistemimit të jashtëm		
	Objekte deri në tre kate	lekë	4000
	Objekte mbi tre kate	lekë	6000
e	Kontroll për lejen e shfrytëzimit		
	Sipeëfaqe për banesë	Lekë/m <sup>2</sup>	50
	Sipërfaqe për biznes	Lekë/m <sup>2</sup>	70
2	Për paisje me leje të re ndërtimi	lekë	10000
3	Rifreskim leje ndërtimi	lekë	10000
4	Për studim urbanistik		
	Nën 300 M2 (parcela)	lekë	8000

	Mbi 300 M2 (parcela)	lekë	10000
5	Planimetri shesh ndërtimi		
	Nën 300 M2 (parcela)	lekë	8000
	Mbi 300 M2 (parcela)	lekë	10000
6	Piketim shesh ndërtimi	lekë/m <sup>2</sup>	25
7	Lëshim dublikat dokumenti	lekë	8000
8	Leje për prishje objekti	lekë	8000
9	Leje për prerje drurësh	lekë	4000
10	Tarifë për paisje me autorizim për punime brendëshme ndërtimi .(rikonstruksione)	vlerë punimi	2%
11	Tarifë për shërbimin ndaj personave që kërkojnë regjistrimin e pasurive (banesave) të ndërtuara përpara datës 10.08.1991	lekë/rast	10000
12	Tarifë aplikimi në sistemin elektronik		
	- për ndertime deri në 250 m <sup>2</sup>	Lekë/rast	4000
	- për ndertime mbi 250 m <sup>2</sup>	Lekë/rast	10000
13	Tarifë aplikimi për punime me deklaram paraprak	Lekë/rast	2500

Këto tarifa administrohen nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorit.

**B.9-** Tarifë për dhënie në përdorim e hapësirës publike, me qëllim vendosjen në shërbim të komunitetit të krevatëve të plazhit, çadrave, dhomave të zhveshjeve, dusheve, shërbimeve higjienike, impianteve dhe pajisjeve për përgatitjen e pijeve dhe ushqimeve, si dhe për kryerjen e veprimtarive të tjera të turizmit ujor.

Nr	Emërtimi i tarifës	Njësia e matjes	2018
1	Tarifë për dhënie në përdorim të sipërfaqes të plazheve.	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	9

Kjo tarife do të llogaritet për periudhen 16 maj – 30 Shtator periudha që përcakton Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.369 date 18.05.2016 për mbajtjen hapur të stacioneve të plazhit, me përjashtim të rasteve kur subjektit në mënyrë të njëanshme i zgjidhet kontrata nga Bashkia dhe kërkohet lirimi i sipërfaqes para kohës së përfundimit të saj, ose për interesa publike nuk i lidhet kontratë në afatet e mësipërme.

Për administrimin e kësaj tarife ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

**B.10- Kamatvonesa për pagesë të vonuar të detyrimit të vitit ushtrimor.**

**B.10.1** Për moslikuidimin në afatin e përcaktuar të detyrimit për taksat e tarifave, subjektet që ushtrojnë biznes, paguajnë kamatvonesa në shumën 0,05 % të detyrimit për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 25 % të detyrimit të vitit ushtrimor. Afati i fundit për pagesën e detyrimeve të vitit ushtrimor për efekt të llogaritjes së kamat vonesave është data 31 Dhjetor. Pas kësaj date fillon llogaritja e kamatvonesave për ditë kalendarike.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, Policia Bashkiake, Zyra e Veterinarisë, Zyra e Gjendjes Civile, Qendra Kulturore dhe Shumësporteve dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Paketa fiskale e vitit 2017 dhe çdo vendim tjetër i Këshillit të Bashkisë, që bie ndesh me Paketën Fiskale të vitit 2018, shfuqizohen me miratimin e kësaj Pakete.

**KRYETARI**

**TATJANA ALIKAJ**



